



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

**Kodi i lëndës: INF 465**

**Lënda: Kirurgji OBS**

PROGRAMI I LËNDËS: <b>Kirurgji OBS</b>									
<b>Titullari i lëndës:</b>		<b>Brunilda Mersini. Dr.në Mjekesi Klinike</b> _____							
<b>Ngarkesa:</b>	Kredite	Orë mësimi në auditor						Studim individual	Totali
		Leksion	Seminar	Labs	Praktikë	Projekte	Total		
	3 ECTS	15	8	0	10	0	33	42	75
<b>Tipologjia e lëndës</b>		Lëndë ndërdisiplinore / integruese							
<b>Viti akademik /Semestri kur zhvillohet lënda</b>		Viti I, Semestri I							
<b>Lloji i lëndës</b>		Me zgjedhje							
<b>Programi i studimit</b>		Master profesional në Infermieri Kirurgjikale							
<b>Kodi i lëndës</b>		INF 465							
<b>Adresa elektronik e titullarit / pedagogut të lëndës</b>		<a href="mailto:bruna.mersini@univlora.edu.al">bruna.mersini@univlora.edu.al</a>							

**PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT**

<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Në këtë modul studiohen problemet kirurgjikale obstetrikale që prekin shtatzanat. Nëpërmjet integritit të njohurive mbi patologjitë kirurgjikale obstetrikale do të trajtohen standartet bashkëkohore mbi trajtimin kirurgjikal dhe parandalimin e këtyre sëmundjeve. Roli i infermieres profesionale që kujdeset për pacientët adultë, do të fokusohet në kontekstin e individit, familjes dhe komunitetit.
<b>Objektivat e lëndës</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>☞ Të hartojnë planet e trajtimit të patologjive kryesore kirurgjikale obstetrikale.</li><li>☞ Të bëjnë diferencimin e trajtimit midis rasteve klinike të ndryshme të të njëjtës sëmundje.</li><li>☞ Të përzgjedhin trajtimin e duhur në rastet klinike me disa sëmundje njëkohësisht.</li><li>☞ Të kenë njohuri për strategjitë moderne të menaxhimit të menaxhimit të femrave me patologji kirurgjikale obstetrikale, përpara dhe pas ndërhyrjes.</li><li>☞ Të aftësohen për një analizë kritike të kërkimit në fushën e patologjive kirurgjikale obstetrikale.</li></ul>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

<b>Rezultatet e pritshme</b>	<p>Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>☞ Të njohë teknikat kirurgjikale të standarteve bashkëkohore.</li><li>☞ Të diagnostikojë patologjitë kryesore kirurgjikale obstetrikale.</li><li>☞ Të kenë njohuri për strategjitë moderne të menaxhimit të femrave me patologji kirurgjikale obstetrikale, përpara dhe pas ndërhyrjes.</li><li>☞ Të aftësohen për një analizë kritike të kërkimit në fushën e patologjive kirurgjikale obstetrikale.</li><li>☞ Të formojnë shprehje për të gjykuar në mënyrë të pavarur modelet ekzistuese dhe të sugjerojnë rekomandime për ndërhyrje në sistem.</li></ul>
------------------------------	---

### KONCEPTET THEMELORE

1. Kirurgjia obstetrikale është një modul në të cilin studentët marrin njohuri për problemet kirurgjikale obstetrikale që prekin shtatzanat.
2. Njohuritë e marra do t'i ndihmojnë ata të diagnostikojnë patologjitë kryesore kirurgjikale obstetrikale.
3. Infermieri i ditëve të sotme duhet të jetë i përgatitur për formimin e shprehive dhe gjykimin në mënyrë të pavarur të modeleve ekzistuese dhe të sugjerojë rekomandime për ndërhyrje në sistem, si edhe të aftësohen për një analizë kritike të kërkimit në fushën e patologjive kirurgjikale obstetrikale.

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
I.	<p><b>Tema 1.</b> Semiologjia e kirurgjisë obstetrikale. Ekzaminimet paraprake të ndërhyrjeve kirurgjikale obstetrikale. <i>Njohja me lëndën dhe semiologjinë e kirurgjisë obstetrikale, dhe cilat janë ekzaminimet paraprake që kryehen përpara ndërhyrjeve kirurgjikale obstetrikale.</i></p> <p><b>Seminar:</b> Përcaktim i temave dhe kërkesave të projekteve të kursit.</p>	<sup>(1)</sup> fq.6-18	Leksion 1 orë  Seminar 1 orë
II.	<p><b>Tema 2.</b> Parimet e menaxhimit infermieror kirurgjikal. Metodot farmakologjike që zbaton infermieri. <i>Evidentimi i parimeve themelore infermiere gjatë menaxhimit infermieror kirurgjikal dhe çfarë metodash zbaton infermieri.</i></p> <p><b>Praktikë</b> në repartin e obstetrikë-gjinekologjisë.</p>	<sup>(1)</sup> fq.94-102	Leksion 1 orë  Praktikë 2 orë
III.	<p><b>Tema 3.</b> Prezentacionet podalike, klasifikimi i tyre dhe biomekanizmi i lindjeve podalike. <i>Njohja me prezentacionet podalike dhe mënyrën e menaxhimit të tyre.</i></p> <p><b>Seminar:</b> Teknikat infermiere gjatë menaxhimit kirurgjikal.</p>	<sup>(1)</sup> fq.150-152	Leksion 1 orë  Seminar 1 orë
IV.	<p><b>Tema 4.</b> Prezentacionet podalike, menaxhimi kirurgjikal. <i>Njohja me prezentacionet podalike dhe mënyrën e menaxhimit të tyre.</i></p> <p><b>Praktikë</b> në repartin e obstetrikë-gjinekologjisë.</p>	<sup>(1)</sup> fq.153-155	Leksion 1 orë  Praktikë 2 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
V.	<b>Tema 5.</b> Prezentacionet transversale, biomekanizmi dhe menaxhimi kirurgjikal. <i>Njohja me prezentacionet podalike dhe mënyrën e menaxhimit të tyre.</i> <b>Seminar:</b> Prezentacionet podalike dhe transversale, klasifikimi i tyre dhe biomekanizmi i lindjeve podalike.	<sup>(1)</sup> <i>fq.156-157</i>	Leksion 1 orë  Seminar 1 orë
VI.	<b>Tema 6.</b> Aborti, format e ndryshme të aborteve, parandalimi i tyre. <i>Njohja me abortin, ndërprerja e barrës gjatë 28 javëve ose gjatë 7 muajve obstetrikalë, dhe kujdesi infermieror në secilën prej tyre.</i> <b>Praktikë</b> në repartin e obstetrikë-gjinekologjisë.	<sup>(1)</sup> <i>fq.157-160</i>	Leksion 1 orë  Praktikë 2 orë
VII.	<b>Tema 7.</b> Gravidanca extrauterine, menaxhimi kirurgjikal i rastit të paraqitur. <i>Njohja me gravidancën extrauterine dhe mënyrën e menaxhimit të situatës.</i> <b>Seminar:</b> Aborti, format e ndryshme të aborteve dhe gravidanca extrauterine.	<sup>(1)</sup> <i>fq.172-174</i>	Leksion 1 orë  Seminar 1 orë
VIII.	<b>Tema 8.</b> Hemoragjitë uterine anormale. Menaxhimi kirurgjikal i tyre. <i>Njohja me hemoragjitë uterine anormal, rastet e menaxhimit kirurgjikale dhe kujdesi infermieror në këto situata.</i> <b>Praktikë</b> në repartin e obstetrikë-gjinekologjisë.	<sup>(1)</sup> <i>fq.188-191</i>	Leksion 1 orë  Praktikë 2 orë
IX.	<b>Tema 9.</b> Placenta previa. Menaxhimi kirurgjikal. <i>Placenta previa është një ndërlikim mjaft i rrezikshëm i barrës, situatë në të cilën placenta është më poshtë se fetusit dhe është vetë pjesë paraqitëse.</i> <b>Seminar:</b> Hemoragjitë uterine anormale dhe placenta previa.	<sup>(1)</sup> <i>fq.194-197</i>	Leksion 1 orë  Seminar 1 orë
X.	<b>Tema 10.</b> Tumoret gjinekologjike. Menaxhimi kirurgjikal. <i>Njohja me tumoret gjinekologjike dhe rastet kur menaxhimi i tyre është kirurgjikal.</i>	<sup>(1)</sup> <i>fq.208-213</i>	Leksion 1 orë
XI.	<b>Tema 11.</b> Shkolitja parakohe e placentës së vendosur normalisht (Distako placente). <i>Njohja me situatat dhe sëmundjet të cilat precipitojnë në shkolitje parakohe të placentës dhe prishin sistemin vaskular.</i> <b>Seminar:</b> Shkolitja parakohe e placentës së vendosur normalisht (Distako placente).	<sup>(1)</sup> <i>fq. 197-198</i>	Leksion 1 orë  Seminar 1 orë
XII.	<b>Tema 12.</b> Operacioni cesarean. <i>Mënyra e realizimit të operacionit cesarean dhe kujdesi infermieror në këtë operacion.</i>	<sup>(1)</sup> <i>fq.199-200</i>	Leksion 1 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<b>Praktikë</b> në repartin e obstetrikë-gjinekologjisë.		Praktikë 2 orë
<b>XIII.</b>	<b>Tema 13.</b> Traumat e lindjes. Laceracionet perineale, të vulvës dhe të vaginës. Teknika infermiere e riparimit të tyre. <i>Njohja me laceracionet e ndryshme të cilat mund të vërehen gjatë lindjes dhe cila është teknika infermiere e riparimit të tyre.</i> <b>Seminar:</b> Ndërhyrja infermiere në epiziotomi dhe laceracione. Operacioni cesarean.	<sup>(1)</sup> fq.201-2074	Leksion 1 orë  Seminar 1 orë
<b>XIV.</b>	<b>Tema 14.</b> Traumat e lindjes. Epiziotomia . Menaxhimi kirurgjikal. <i>Njohja me laceracionet e ndryshme të cilat mund të vërehen gjatë lindjes dhe cila është teknika infermiere e riparimit të tyre.</i> <b>Seminar:</b> Traumat e lindjes. Laceracionet perineale, të vulvës dhe të vaginës. Epiziotomia . Teknika infermiere e riparimit të tyre.	<sup>(1)</sup> fq.205-207	Leksion 1 orë  Seminar 1 orë
<b>XV.</b>	<b>Tema 15.</b> Përmbledhje e problematikave obstetrikale që kërkojnë menaxhim kirurgjikal.		Leksion 1 orë

**FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE**

<b>FREKUENTIMI:</b>	Kyçi i një edukimi të suksesshem është pjesëmarrja dhe përgatitja. Kërkohej një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e praktikës janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuara ora do të zëvendësohet në marrveshje me pedagogun. Të gjithë studentët duhet të paraqiten në orët e praktikës në orarin e përcaktuar dhe të pajisur me përparëse të bardhe dhe flokë të mbledhur (duke respektuar kodin etik të veshjes së infermierit). Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuara. Në të kundërt studentit humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura.					
<b>KONTROLLI I VAZHDUESHËM</b>	<i>Forma e vlerësimit</i>	<i>Koha e vlerësimit</i>	<i>Temat mësimore që do vlerësohen</i>	<i>Pikët maksimale</i>	<i>Forma e testimit të njohurive</i>	<i>Përmbajtja e testimit</i>
	Provimi final	Fundi i semestrit	Lex 1-15	90 pikë	Provimi me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz
	Vlerësim i vazhduar* (Detyra e kursit*)	Java 14/15	Rastet klinike	10 pikë	Provimi me gojë	Raportim rasti
	*Vlerësim i vazhduar - Do të realizohet prej pedagogut për gjatë gjithë semestrit. Studentët do të prezantojnë detyren me gojë					
	Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare është si më poshtë:					
40- 49 pikë	50-59 pikë	60-69 pikë	70-79 pikë	80-89 pikë	90-100 pikë	
5	6	7	8	9	10	

**LITERATURA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"  
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK  
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

<b>Literatura bazë</b>	(1)'Obstetrika' H.Kosova 2008
<b>Literatura e rekomanduar</b>	Midwifery and Obstetrical Nursing, <a href="#">Piyush Sharma</a> (2009) ISBN-10: 8190867547 Medical-Surgical Nursing' L.Williams, P.Hopper 2015 'Human diseases' Tannehill-Jones 2017

**VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS**

<b>Dispozita:</b>	Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregon interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto pritshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjate procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse përsonat me aftësi të kufizuara.
<b>Vonesat</b>	Vonesat në leksione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student.
<b>Sjellja profesionale e studentit</b>	Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digjitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti nëpër tavolinat e mësimin, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimin, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijancë nga këto rregulla, do të ketë penalitete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.
<b>Integriteti akademik dhe e drejta e autorit</b>	Çdo test apo punë me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale. Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale, dhe në pamundësi të referojnë gjithnjë burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzjerjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme.